



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	06.03.2018
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raporti punës–Muaji Shkurt 01.02.2018-28.02.2018

DKA çdo herë është në shërbim të shkollës, veçanërisht të çdo zhvillimi dhe aktiviteti i cili është në të mirë të procesit edukativo-arsimor, kështu që edhe gjatë muajit shkurt ka kryer punë dhe aktivitete të ndryshme dhe atë:

Vizitë pune - monitorimi dhe kontrollimi i punës në shkolla me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe shtimin e përgjegjësisë së personelit të shkollës:

- SHML Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan
- Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan dhe
- Shfmu “Vilezërit Frashëri” në Lipjan

Vlerësimi i dosjeve të mësimeve të mësimdhënësve që kanë përfunduar trajnimin për fushën e Tik-ut dhe fushën e Artet.

Pjesëmarrja e zyrtarëve në trajnimin 3-ditor mbi "Bashkëpunimin Ndërsektorial" të projektit GIZ "Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin Fillor në Kosovë /CDBE".

Kërkesë DSHP-së për hartimin e paramasës dhe parallogarisë:

- Rrënimi i një pjese të shkollës së vjetër për ndërtimin e shkollës së re në SHMP “Adem Gllavica” në Lipjan,
- Riparimi i nyjeve sanitare në Shfmu “Zenel Hajdini” në Gadime.

Kërkesë DPU-së për hartimin e paramasës dhe parallogarisë:

- Rregullimi i infrastrukturës në oborrin e shkollave: Shfmu “Haradin Bajrami” në Magure, p.n.f Mirenë dhe Shfmu “Nezë Bujani” në Bujan, p.n.f Bregu i Zi,
- Riparimi i kulmit komplet në Çerdhën në Lipjan.

Kërkesë DP-së për zhvillimin e procedurave të prokurimit:

- Ndërtimi i shkollës në Shfmu “Drita” në Rubovc,
- Furnizimi i busave me goma,
- Furnizimi me mallra për mbjelljet pranverë-vjeshtë (ekonomia bujqësore).

Kërkesë komisionit vlerësues të pasurisë për heqjen e materialit jo të përdorshëm nga shkollat (kompjutera, banka, karrika, shtypës, stufaetj).

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor, dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime–kthimi nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit, shtimi i përvojës,
- Formular për largim–skadim kontrate, pensionimi,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme -ndërrimi i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme konform nevojave të shkollave.